

NDËRTIMI DHE FORCIMI I KAPACITETIT TE KOMUNITETIT TË OJQ-VE NE VITE



VITI 1999



Bazuar në përvojën e stafit të Fondacionit dhe atë të kordinatorëve lokale të trajnuar, ndërtimi i kapacitetit dhe transmetimi i kësaj përvoje në rrethe të largëta të vendit, ku mungojnë tërësisht mundësitë për t'u trainuar, është shumë i rëndësishëm. Vlen të përmendet se në zonat e thella të vendit ka mungesë të theksuar informacioni dhe njohurish

lidhur me shoqërinë civile, rolin e shoqatave, pjesëmarrjen publike në nivelin e komunitetit, ndërkohë që në qytetet më të mëdha, veçanërisht vitin e fundit janë krijuar OJQ të cilat kanë filluar të hedhin hapat e para në fushën e veprimtarisë shoqërore.

Gjatë vitit 99 Fondacioni zbatoi fazën e dytë të programit për forcimin e kapacitetit dhe fuqizimin e komunitetit të OJQ-ve. Është e rëndësishme të theksohet se Fondacioni ka fokusuar përpjekjet e tij në forcimin e kapacitetit të OJQ-ve nëpërmjet trainimeve të drejtuesve të OJQ-ve lokale. Dy vjet më parë ky projekt filloi me mbështetjen financiare të Fondacionit Mott (SHBA) dhe gjatë periudhës 1997-98 u përgatiten 15 trajnues lokale të përzgjedhur nga 12 rrethe të vendit. Trajnimi intensiv dhe në disa faza i tyre solli frutet që priteshin. Këta persona, gjatë vitit të kaluar qënë aktore aktive në realizimin e trajnimeve lokale. Ata luajtën rolin e kordinatorit dhe lehtësuesit të tryezës së punës dhe, për tema të veçanta të trainuesit, duke sjellë eksperiencë pozitive nga rastet e suksesshme të shoqatave të tyre.



Gjatë vitit 99 janë realizuar gjashtë seminare: Kavajë, Elbasan, Gramsh, Pogradec, Korçë dhe Krujë. Në çdo seminar trainimi morën pjesë 18 drejtues të OJQ-ve lokale dhe 2 përfaqësues të pushtetit lokal.

Disa arritje në realizimin e këtij programi për vitin 99 janë:

- Janë trainuar përfaqësues të OJQ-ve dhe pushtetit lokal me tema si: njohuri mbi shoqërinë civile, njohja e legjislacionit për OJQ-të, hartimi i planit strategjik, hartimi i projekt-propozimit, përgatitja e projekt-buxhetit, llogari-mbajtja, gjetja e donatorëve, ngritja e fondeve etj.
- Nga sektori i OJQ-ve u trainuan 125 vetë. Pjesëmarrësit në trainim u përzgjedhën nga kordinatorët lokale bazuar në disa kritere si: shpërndarja racionale gjinore, përparësi të rinjve në moshë, drejtues të shoqatave (kryetar ose anëtar bordi apo komiteti drejtues), të ngarkuar për përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve, përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të komunitetit lokal të OJQ-ve.
- Në global, pjesëmarrja e gruas arriti shifrën 55% të të trainuarve ndërsa

- pjesëmarrja e të rinjve ishte 40% e tyre. Këto shifra janë të kënaqshme po të marrim parasysh se në rrethe përgjithësisht angazhimi i të rinjve në shoqata është i vogël.
- Për herë të parë u përfshinë në trainim 10 përfaqësues të pushtetit lokal, disa prej të cilëve ishin drejtues të Bashkisë së qytetit Kavajë, Gramsh, Korçë, Elbasan etj. Në këtë mënyrë po bëhen përpjekje për të vendosur ura bashkëpunimi midis OJQ-ve dhe pushtetit lokal.
 - Të trainuarit, në bazë të një formulari standart, vlerësuan elementët kryesore të seminarit si niveli i leksioneve, i lektorëve, dobia e paketës së leksioneve, mënyra e organizimit etj. Përgjithësisht vlerësimi është superlativ. Bordi diskutoi dhe gjykoi se një sërë arsyesh justifikojnë këtë nivel vlerësimi si: për të gjithë ishte hera e parë që merrnin pjesë në trainim dhe nuk kishin standart referimi parardhës, nuk janë të familjarizuar me teknikat e vlerësimit, ka mungesë kurajo për të qënë kritik dhe të hapur për të bërë vërejtje .

Krahas kësaj në bashkëpunim me OSBE, në vazhdim të projektit të përbashkët të filluar në vitin 1998, në qershor 99, Fondacioni realizoi një trainim intensiv të 15 OJQ-ve në qytetin e Korçës (dy ditë).

“**Si uji në shkretëtirë**” – kështu e cilësoi seminarin njëri prej pjesëmarrësve të OJQ-ve të Korçës.



VITI 2000

FSHSHC e ka përqendruar një pjesë të përpjekjeve të veta edhe në rritjen e kapacitetit të OJQ-ve në të gjithë vendin. Bazuar në përvojën e fituar me trajnimin e trajnerëve u organizua puna që eksperiencia e vlefshme të transmetohej tek njerezit që punojnë në sferën e Shoqërisë Civile. Në vendin tonë ka mungesë informacioni dhe njohurish mbi rolin e Sektorit të Tretë. Po ashtu, aktiviteti i OJQ-ve në rrethe dhe jashtë kryeqytetit është i dobët. Për këtë arsye ne e përqendruam aktivitetin në këto rrethe. Viti 2000 pati një veçori tjetër, sepse prej Fondacionit MOTT u dha një fond shtesë, i cili u vendos të shpenzohej për punët praktike pas seminareve dhe për ngritjen e një rrjeti bashkëpunimi dhe informacioni ndërmjet OJQ-ve të trajnuara.

Objektivat kryesore ishin si me poshtë :

- Zhvillimi dhe përmirësimi i programit të trajnimit për seminarët, në mënyrë që t'i përshtatet kërkesave kryesore të drejtuesve të OJQ-ve.
- Përgatitja e materialeve të shkruara për të pajisur pjesëmarrësit në çdo seminar.
- Angazhimi i të Trajnuarve në programin TOT dhe seminarët e vitit të kaluar si koordinues lokal dhe lehtësues.
- Trajnimi i rreth **180** vetave nga OJQ-të lokale dhe **18** përfaqësuesve të pushtetit lokal në seminarët e planifikuara.
- Vendosja e bashkëpunimit më të ngushtë dhe krijimi i një RRJETI ndërmjet OJQ-ve, sipas mundësive në terren.

Zgjedhja e temave u bazua në nevojat për të realizuar një formim komplet të drejtuesve të OJQ-ve si edhe të eksperiencës së vitit të kaluar, temat kryesore ishin:

1. Aspekte ligjore dhe Projekt Ligji i ri për OJQ-të.
2. Sektori i tretë dhe roli i tij në shoqëri.
3. Planifikimi strategjik.
4. Projekt propozimet për realizimin e planit strategjik.
5. Buxheti dhe llogarimbajtja.
6. Gjetja e fondeve.
7. Si të kërkohen donatorët.
8. Planifikimi i fushatës për gjetje fondesh, etj.

Seminaret u zhvilluan në nëntë rrethe të ndryshme si: Durres, Shijak, Librazhd, Permet, Burrel, Peshkopi, Bulqize, Vlore.

Në seminare morën pjesë përfaqësues të **135 OJQ-ve**. Ata kryesisht ishin drejtues dhe anetarë të thjeshtë, që nuk ishin trajnuar më parë. Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve ne kemi patur kujdes të jete të pranishëm nga gjitha moshat dhe gjinitë. Në seminare e zhvilluara morën pjesë 14 përfaqësues të pushtetit lokal, çka përkon me **78%** të pjesëmarrjes së pritshme, të synuar prej nesh. Edhe ky rezultat përbën një arritje, pasi tregon vlerësimin prej pushtetit lokal të punës dhe aktivitetit të OJQ-ve në rrethin ku ato zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Pjesëmarrësit nga pushteti lokal, në disa raste, ishin drejtues të Bashkive ose Drejtorë të Drejtorive në Bashki ose Prefekturë.

Lidhur me përbërjen e pjesëmarrësve në çdo seminar rendisim këto shifra:



***Pjesëmarrja e Grave ka qënë 60 %
Të rinjtë pjesëmarrës kanë qënë 35 %
Mbi moshën 40 vjeç ka pasur një
pjesëmarrje prej 24 %***

Vlerësimi i seminareve u bazua në formularin që jep informacion mbi shumë aspekte të seminarit, duke krijuar një profil të tij, ashtu si u vlerësua nga vetë pjesëmarrësit .

Nga qyteti në qytet rezulton se pjesëmarrësit e vlerësuan seriozisht këtë pjesë të seminareve, sepse ato ishin aktivë në plotësimin e tyre, duke mos mbetur anonim. Vetëm në pak raste pjesëmarrësit mbetën anonime në vlerësimet e veta. Megjithatë rezultatet flasin për një vlerësim **shumë të mirë**, kurba e profilit të seminarit tregon dhe pika të dobta të cilat kanë nevojë të rishikohen dhe përmirësohen. Përgatitja e Treguesve dhe Pyetsoreve Vlerësues do të përbejë një objekt tjetër të punës së mëtejshme të këtij projekti.

Gjatë vitit të kaluar gjithashtu u realizuan punë praktike me organizata të trajnuara më parë.

Programi shtese me punet praktike u krye si më poshtë:

- Përgatitja dhe realizimi i **6 Puneve Praktike**, në gjashtë rrethe, ku më parë ishin zhvilluar seminare
- Trajnimi praktik i **120** vetave nga OJQ-te lokale si edhe i disa përfaqësuesve të pushtetit lokal.
- Angazhimi si kordinatorë lokale dhe lehtesues i të trajnuarve nga seminare e mëparshme.
- Vendosija dhe krijimi i një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve të trajnuara sipas kushteve

ekzistuese në terren.

Ndryshimi thelbësor i këtyre punëve nga seminarët qëndron në faktin se pjesëmarrësit punojnë në grupe, hartojnë nga një projekt mbi një ide të zgjedhur nga vetë pjesëmarrësit pas diskutimesh dhe pastaj prezantojnë në grup punën e bërë. Zgjidhet Projekti më i mirë dhe pastaj, me ndërhyrjen e trajnuesve, korrigjohet dhe plotësohet. Një rrjedhë e tillë pune vazhdoi në të gjitha Punët Praktike dhe rezultatet janë inkurajuese. Punët Praktike u bënë në 6 rrethe të vendit: Librazhdi, Gramshi, Elbasani, Permeti, Durrësi, Vlora.

Pjesëmarrja në punët praktike ishte e kënaqshme. Përfaqësues të **103 OJQ-ve** morën pjesë në to. Ata u zgjodhën në bashkërendim me Kordinatorin Lokal, duke synuar të ishin ata të trajnuar në SEMINAR. Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve kemi patur kujdes të kemi të pranishëm nga të gjitha moshat dhe gjinitë.

Vetëm 8 përfaqësues të pushtetit lokal morën pjesë në Punët Praktike - çka është e barabartë me 67% të vlerës së pritshme. Numri i përgjithshëm i të trajnuarve në punët praktike ishte 108, çka do të thotë me pak se 20 pjesëmarrës për çdo qytet. Pjesëmarrësit gra ishin 65%, të rinj 35% dhe ato të moshës mbi 40 vjeç 30%.



VITI 2001

FSHSHC ka përqëndruar një pjesë të mirë të përpjekjeve të tij dhe në rritjen e kapacitetit të OJF-ve në të gjithë vendin. Bazuar në trashëgiminë e fituar me trajnimin e trajnerëve, trajnimin e OJF-ve gjatë vitit 2000, ne organizuam punën duke synuar që përvoja e vlefshme të transmetohej tek njerëzit që punojnë në mjedisin e shoqërisë civile. E veçanta për këtë vit ishte financimi nga Fondacioni SOROS i një projekti trajnimi mbi përkatësinë gjinore, i cili iu bashkangjiti aktiviteteve të trajnimit. Si

rrjedhim u pasurua edhe paketa e moduleve të trajnimit si dhe u plotësua me tema shtesë.





Në kuadrin e projektit të trajnimit të mbështetur nga fondacioni MOTT gjatë vitit 2001 ne e përqëndruam punën dhe përpjekjet tona në rrethe të vogla dhe të largëta dhe veçanërisht tek ato OJF të cilat nuk ishin trajnuar dhe nuk kishin përvojë. Ne kemi realizuar trajnime bazë, të përparuara ,

si dhe kemi trajtuar tema të veçanta mbi menaxhimin dhe përdorimin e kornizës logjike në planifikimin e projekteve.

Objektivat kryesore të programit të trajnimit për vitin 2001 ishin :

- Zhvillimi dhe përmirësimi i programit të trajnimit për seminarët në mënyrë që t'i përshtatet kërkesave kryesore të drejtuesve të OJF-ve.
- Pasurimi i moduleve të trajnimit me tema bashkëkohore dhe të kërkuara prej donatorëve si dhe të diktuar nga nevojat e evidentuara nëpër rrethe.
- Angazhimi i të trajnuarve në programin TOT dhe seminarët e vitit të kaluar si koordinatorë lokal dhe lehtësues apo pjesëmarrës aktiv në aktivitetet e zhvilluara në rrethe.
- Organizimi i trajnimeve në 18 rrethe të vendit.
- Trajnimi i rreth 320 vetave nga OJF-të lokale dhe 32 përfaqësuesve të pushtetit lokal.
- Vendosija e një bashkëpunimi më të ngushtë dhe nxitja e punës së rrjetit të krijuar ndërmjet OJF-ve sipas mundësive në terren.
- Transferimi i informacioneve në lidhje me gjetjen e fondeve tek forumet e OJF-ve lokale.
- Bashkëpunimi me Fondacionin SOROS për trajnime mbi Përkatësinë Gjinore

Zgjedhja e temave u bazua në nevojat për të realizuar një formim sa më të plotë të drejtuesve të OJF-ve si edhe të përvojës së vitit të kaluar. Në këtë vit u shtua edhe tema e re mbi përkatësinë gjinore në kuadrin e një bashkëpunimi me Fondacionin SOROS si edhe me Qendrën e Gruas – Tiranë. Futja e kësaj teme e pasuroi dhe e bëri mjaft interesant për pjesëmarrësit të gjithë trajnimin tre-ditor, gjë që reflektohet edhe në vlerësimet e tyre. Gjatë këtij viti janë zhvilluar këto tema si: aspekte ligjore dhe tipare të ligjit për OJF-të, sektori i tretë dhe roli i tij në shoqëri, planifikimi strategjik, projekt propozimet për realizimin e planit strategjik, buxheti dhe llogarimbajtja, gjetja e fondeve, vlerësimi i aftësive të shoqatës për gjetje fondesh, si të kërkohen donatorët e mundshëm, planifikimi i fushatës për gjetje fondesh, përkatësia gjinore.

Fillimisht u planifikuan 7 seminarë, më pas duke u mbështetur në nevojat e evidentuara si edhe në rezultatet mjaft inkurajuese dhe efikase në punët praktike të zhvilluara shume shpejt mbas seminarëve, ne e ulëm në 5 numrin e seminarëve dhe rritëm numrin e punëve praktike nga 7 në 11. Seminarët u zhvilluan në pesë rrethe të ndryshme: Shkoder, Berat, Lezhë, Sarandë dhe Lushnjë

Në seminarë morën pjesë përfaqësues të 55 OJF-ve . Kryesisht ato ishin drejtues dhe anëtarë të thjeshtë të cilët nuk ishin trajnuar më parë. Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve kemi bërë kujdes që të jenë të pranishëm nga gjithë moshat dhe gjinitë. Listat e pjesëmarrësve janë të detajuara dhe arshivuara për çdo aktivitet.


Nga pushteti lokal morën pjesë 9 përfaqësues në 5 seminarët e zhvilluara gjë që përkon me 90% të pjesëmarrjes së pritëshme nga ne. Edhe ky rezultat përbën një arritje pasi tregon vlerësimin prej pushtetit lokal të punës dhe aktivitetit të OJF-ve në rrethin ku ato zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Pjesëmarrësit nga pushteti lokal në disa raste ishin drejtues të bashkive ose drejtorë të drejtorive në bashki ose prefekturë. Shembujt më të mire janë ato të Pushtetit Lokal të Lezhës, Beratit, Sarandës dhe Lushnjës.

Numri i përgjithshëm i të trajnuarve gjatë vitit 2001 ishte 102, që do të thotë afërsisht 20 veta për çdo rreth. Qëllimi ynë ishte që të kishim një shpërndarje racionale të pjesëmarrësve të rinj nga të dy gjinitë si edhe më të moshuar me një eksperiencë të mirë. Duke gjykuar nga listat e pjesëmarrësve në çdo seminar rendisim këto shifra:

- Pjesëmarrja e Grave ka qenë 58%;
- Të rinjtë pjesëmarrës kanë qenë 35%
- Mbi moshën 40 vjeç ka patur një pjesëmarrje prej 26 %

Vlerësimi i seminareve edhe këtë vit u bazua në formularin e hartuar vjet, ku jepet informacion mbi shumë aspekte të seminarit dhe na krijon një profil të seminarit ashtu siç është vlerësuar nga pjesëmarrësit. Nga qyteti në qytet ne kemi evidentuar se pjesëmarrësit e vlerësuan seriozisht këtë pjesë të seminareve sepse ato ishin aktivë në plotësimin e tyre duke dhënë dhe vlerësimet përkatëse. Vetëm në pak raste pjesëmarrësit deshën të mbeten anonim në vlerësimet e tyre. Opinione të shprehura në formulare do të na ndihmojmë për përmirësimin e punës në të ardhmen. Megjithatë rezultatet flasin për një vlerësim shumë të mirë, kurba e profilit të seminarit tregon dhe pika të dobëta relativisht që kanë nevojë për t'u rishikuar dhe përmirësuar.

Bashkëngjitur po japim një vlerësim të bërë prej pjesëmarrësve në një seminar. [Shkodër]



Në programin e trajnimit u përfshinë edhe punë praktike, të cilat u panë të domosdoshme për të rritur aftësitë e anëtarëve të OJF-ve duke shkruar dhe hartuar projekte nën drejtimin e grupit tonë të trajnuesve.

Plani i punëve praktike konsistonte në sa vijon:

- Përgatitja dhe realizimi i 7 punëve praktike në shtatë rrethe ku më parë ishin zhvilluar seminare.
- Angazhimi si kordinatorë lokalë dhe raportues i të trajnuarve nga seminarët e mëparëshme.
- Trajnimi i 140 përfaqësuesve të OJF-të lokale si edhe disa përfaqësuesve të pushtetit lokal.
- Vendosja dhe krijimi i një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet OJF-ve të trajnuara sipas kushteve ekzistuese në terren.

- Pasurimi i temave të trajnimit me futjen e disa elementëve të rinj të nevojshëm si :
 - korniza logjike në planifikim sipas objektivave
 - menaxhimi i ciklit të plotë të projekteve
 - praktika në analizën e problemeve dhe të objektivave dhe pema e tyre.

Programi i punëve praktike u zhvillua në dy ditë dhe u trajtuan temat e parashikuara të cilat u realizuan plotësisht. Gjatë punës praktike pjesëmarrësit punuan në grupe, hartuan nga një projekt mbi një ide të zgjedhur nga vetë pjesëmarrësit pas diskutimesh dhe pastaj u prezantua puna e bërë në grup. Projekti u bë sipas metodës së kornizës logjike, fillohet me analizën e problemeve, të objektivave, ndërtimit të pemëve të tyre dhe pastaj kalohet në planifikimin e aktiviteteve dhe mbi bazën e tyre bëhet buxheti. Plani kalendar i zbatimit të projektit si edhe elementë të vlerësimit të tij përbëjnë dhe fazën e menaxhimit të projektit si edhe të vlerësim- raportimit. Zgjidhet projekti më i mirë dhe pastaj me ndërhyrjen e trajnuesave korrigohet dhe plotësohet. Një rrjedhe e tillë pune vazhdoi në të gjitha punët praktike dhe rezultatet janë inkurajuese. Vlerësime të veçanta u bënë nga përfaqësues të pushtetit lokal të cilët i konsiderojnë të domosdoshme këto metoda logjike për punën e tyre të përditëshme në menaxhim projektsh dhe situatash.

U realizuan kështu 11 Pune Praktike në 11 rrethe të vendit: Kavaja, Kruja, Burreli, Korça, Pogradeci, Kuçova, Shkodra, Berati, Lezha, Lushnja, Peshkopia

Punët praktike në Lushnje, Berat, Lezhë dhe Shkodër janë realizuar shumë shpejt pas seminareve dhe me rezultate shumë të mira.

Pjesëmarrja në punët praktike ishte shumë e mire, përfaqësues të 203 OJF-ve morën pjesë në punë praktike. Ato u zgjedhën në bashkërendim me kordinatorin lokal duke synuar që të ishin ato të trajnuar në seminare. Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve u bë kujdes që të kemi të pranishëm nga gjithë moshat dhe gjinitë.

Gjithashtu 18 përfaqësues të pushtetit lokal morën pjesë në punët praktike që është e barabartë me 77% të vlerës së pritëshme. Rezultati është më i ulët se me pjesëmarrjen në Seminare. Pjesëmarrësit më aktivë ishin në rrethet Lezhë, Berat, Sarandë, Krujë dhe Peshkopi. Ne tashmë kemi kërkesa për trajnim nga Bashkia Lezhe , dhe Bashkia Elbasan për të trajtuar “Menaxhimin e një Cikli të Plotë Projekti” dhe “Metodën e Kornizës Logjike”.

Numri i përgjithshëm i të trajnuarve në punët praktike ishte 218, që do të thotë rreth 20 pjesëmarrës për çdo qytet. Gra pjesëmarrëse ishin 67%, të rinj 40% dhe të moshës mbi 40 ishim vjeç 28%.

Gjatë këtij viti u pasurua paketa e trajnimit me futjen e elementëve nga temat e reja të përgatitura prej ekipit trajnues. Këto tema janë: Metoda e Kornizës Logjike në Planifikimin e Projekteve sipas Objektivave dhe Menaxhimi i një Cikli të Plotë Projekti.

Nje element i ri gjatë trajnimeve të këtij viti ishte futja e temës “Përkatësia Gjinore” që u realizua si bashkëpunim me Fondacionin SOROS dhe Qendrën e Gruas-Tiranë.



VITI 2002

Gjatë vitit 2002 aktiviteti i FSHSHC ishte fokusuar kryesisht në Programin e Ngritjes së Kapaciteteve, Zhvillimi i Forumeve Lokale të OJQ-ve me qëllim forcimin e

Sektorit jofitim prurës në Shqipëri dhe në veçanti në zonat e largëta të vendit.

Përhapja e informacionit dhe Asistenca Teknike OJQ-ve konsiston si sferë e tretë e aktivitetit.

Këtë vit Programi i Ngritjes së Kapaciteteve ishte karakterizuar nga një pjesëmarrje e gjerë e autoriteteve të qeverisë lokale në sesionet e trainimit që ne kemi mbajtur në krahina të ndryshme të vendit.. Kjo ishte bazuar në prirjen tonë të orientuar në programin e Ngritjes së Kapaciteteve përmes qeverisjes lokale në bashkëpunim me Organizatat jo qeveritare lokale.

Duke konsideruar aspekte të rëndësishme në aktivitetet e FSHSHC ne vazhduam me zhvillimin e modeleve pilot në qytete si :Peshkopi, Bulqizë, Burrel dhe Përmet, ku forumet lokale të organizatave jo qeveritare u mbështetën me materiale të nevojshme logjistike për zhvillimin e dialogut dhe debatit me qeverisjen lokale, organizuam aktivitete të ndryshme veçanërisht me të rinjtë dhe qytetarët e zonave urbane dhe të thella përreth tyre.

Për herë të parë FSHSHC mbështeti skemën pilot për çështjet e zhvillimit ekonomik dhe social në zonat rurale të Tiranës si edhe projekte të forcimit të shoqatave të cilat janë duke kontribuar me konkluzionet e tyre në formulimin e politikave për zhvillimin e zonave rurale në veçanti.

Hyrja e Teknologjisë së Informimit ishte një arritje përmes krijimit të Qendrës së Internetit, e cila është kthyer një burim informimi dhe edukimi për një pjesë të konsiderueshme të organizatave jo-qeveritare dhe komunitetin afër Fondacionit Shqiptar të Shoqërisë Civile në Tiranë.

FSHSHC ka konsoliduar më tej bashkëpunimin dhe partneritetin me donatorë të tjerë si Banka Botërore, Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (SOROS), Fondacionin Charles Steëart Mott dhe të tjerë.

Sipas projektit të paraqitur dhe bashkëfinancimit nga Fondacioni MOTT dhe Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë Civile për vitin 2002 ne kemi arritur objektivat e mëposhtme :

- 7 seminare tre-ditëshe në zona të ndryshme të vendit.
- 7 punë praktike në krahinat ku më perpara ishin zhvilluar seminare tri-ditëshe
- 4 seminare një ditore mbi njohuritë bazë rreth shoqërisë civile dhe aktiviteteve në këtë sektor
- Përmes këtyre aktiviteteve ne kemi ndër mend të trainojmë 220 njerëz të cilët janë anëtarë të 105 organizatave jo qeveritare në krahinat respektive
- Të inkurajojmë krijimin e organizatave jo qeveritare në këto krahina dhe komunat ku nuk ka aktivitet të këtij lloji.
- Të rrisim numrin e projekteve të hartuara nga organizatat jo qeveritare në 20% dhe të përmirësojmë cilësinë e projekteve të prezantuara dhe të rrisin numrin e fituesve të granteve.
- Të nxisim dhe krijojmë rrjetin e organizatave jo qeveritare që veprojnë nëpër krahina, kështu që ato mund të fitojnë informacion dhe eksperiencë në zbatimin e projektit
- Të krijojmë Qendrat e organizatave jo qeveritare në disa krahina dhe të dinë të përdorin me mirë kompjuterin dhe printerin, të cilat kane qenë dhënë në kontekst të këtij projekti
- Pajisja e disa Forumeve të organizatave jo qeveritare në krahina të ndryshme me

kompjutera dhe printera në përputhje me rrjetin e organizatave jo qeveritare dhe shkëmbimin e informacionit midis tyre.



Ne pothuajse i kemi realizuar aktivitetet që përputhen me objektivat e projektit.

Trainerët kanë përmirësuar dhe pasuruar materialet e shkruara të cilat ne i shpërndajmë pjesëmarrësve në lidhje me pikat e mëposhtme: Shoqëria Civile, Ngritja e Fondeve, Planifikimi i Projekteve.

Skuadra e trainimeve e FSHSHC ka ndërmend që të përfshijë tema të tjera të tilla si Metoda e Kornizës Logjike dhe Menaxhimi i Ciklit të Projektit për një nivel të lartë dëgjuesish dhe veçanërisht për qeveritarët lokale.

Në periudhën Mars – Qershor 2002 ne planifikuam punë praktike që vijnë pas seminareve teorike që ne kemi organizuar më herët. Në fakt ne drejtojmë 3 punë praktike nga 7 të cilat ne i kishim planifikuar në krahinat e mëposhtme : Sarandë, Fier dhe Gjirokastrë. 45 Organizata Jo-qeveritare morën pjesë në training dhe 64 pjesëmarrës u trainuan. 11 nga të cilët ishin nën moshën 25 vjeç, 38 persona të moshës 25 – 40 vjeç dhe 15 pjesëmarrës ishin mbi 40 vjeç. Kjo statistikë tregon se nuk është angazhim i mjaftueshëm i të rinjve për zhvillimin e shoqërisë civile.



Gjatë kësaj periudhe ne kemi organizuar 4 seminare teorike duke ndjekur planin në krahinat e Gjirokastrës, Fier, Kukës dhe Rrëshen. Në këto seminare u trainuan 90 pjesëmarrës duke përfshirë përfaqësues nga qeveria vendore (përveç Fierit në të gjithë krahinat e tjera ishin 2 përfaqësues të qeverisë vendore).

Ato përfaqësonin 59 Organizata Jo-qeveritare në krahinat e përmendura më sipër.

Seminaret teorike ishin ndjekur me një interes të lartë sidomos në krahinën e Kukësit, Gjirokastrës dhe Rrëshenit. Një vlerësim është dërguar në Fondacion nga Organizatat Jo-qeveritare të Kukësit që është publikuar në gazetën e Fondacionit. Ne mendojmë se qëllimi i projektit dhe objektivat e përgjithshme të tij u arritën në përputhje me projektin e aprovuar dhe mbështetur nga Fondacioni MOTT.

Ne gjithashtu organizuam seminare një-ditore, të cilat ishin shumë efektive në këto krahina ku nuk ishin shumë të dukshme aktivitetet e shoqërisë civile. Këto krahina ishin Konispoli, Çorovoda dhe Bilishti. 64 persona ishin trainuar dhe ato ishin kryesisht intelektuale që punonin në fushën e edukimit, bujqësisë, administrimit të

kafshëve. Përfaqësues nga Organizata Jo-qeveritare ishin shumë të kufizuara. Vetëm në Konispol kishte përfaqësues nga Organizata Jo-qeveritare e veteranëve, e bletërritësve dhe organizata kulturore Çamëria. Veç kësaj në Konispol merre pjesë në seminar edhe një përfaqësues i pushtetit vendor. Aktivitetet e mësipërme tregojnë se në këto komunitete aktivitetet e shoqërisë civile ishin të kufizuara, atje një grup njerëzish besonin në zhvillimin e këtij sektori dhe u interesuan që të trainoheshin për zgjidhjen e problemeve që preokupojnë komunitetin në përgjithësi. Inkurajimi i sektorit të shoqërisë civile përmes këtyre seminarëve është një sipërmarrje pozitive në kuadrin e këtij projekti.

Ne mendojmë se këto aktivitete ishin të suksesshme dhe përkrijnë me qëllimin e projektit Ne shpresojmë të kontribuojmë së paku në krijimin e një numri modest të Organizatave Jo-qeveritare në këto komunitete.



Faktorët që ishin të dobishëm në arritjen në afat të aktiviteteve ishin:

- Bashkepunimi me kordinatorët lokale të Fondacionit Shqiptar të Shoqërisë Civile në krahina.
- Puna përgatitore dhe vizitat në krahinat e planifikuara për trainim.
- Kontakte direkte me udhëheqësit e Organizatave Joqeveritare në krahina për të përcaktuar dhe afatin e kurseve të trajnimit ose për të zgjedhur pjesëmarrësit të cilët kanë nevojë për tu trainuar.
- Gjetja e vend-takimeve të përshtatshme për trainim.
- Punë përgatitore për materialet e shkruara në formën e dosjeve komplete për çdo pjesëmarrës.
- Njohuritë dhe përgatitjet e duhura për trainerët.

Karakteristikat e kësaj faze :

- Rritja e interesit të pjesëmarrësve në temat e trainimit.
- Pjesëmarrja aktive në punën me grupe prej 5 vetash.
- Përmirësimi i cilësisë së pranimit të projekt-propozimeve
- Ide për projekte të përbashkëta në rrjetin e Organizatave Joqeveritare
- Qendrueshmëria e ulët e aktivitetit të OJQ në krahina
- Krijimi i lidhjeve ndërmjet OJQ duke përfshirë në programin e trainimit dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre.
- Mungesa e donatorëve në Shqipëri
- Lehtësira në shkrimin e projekteve dhe shpërndarjen në këto krahina, ku qendrat e OJQ kanë qënë ngritur dhe janë furnizuar me kompjutera dhe printera në përputhje me projektin.
- Një bashkëpunim i ri ishte krijuar ndërmjet Fondacionit Shqiptar të Shoqërisë Civile dhe Fondacionit SOROS duke përfshirë module trainimi në çështjet gjinore në seminarët e Fondacionit Shqiptar të Shoqërisë Civile. Këto projekte

shtesë pasurojnë të dhënat aktuale dhe aftësojnë pjesëmarrësit që të fitojnë disa njohuri në çështjet gjinore.



VITI 2003

Një nga objektivat e Fondacionit Shqiptar të Shoqërisë Civile ka qënë decentralizimi i aktivitetit të tij. Për ta realizuar këtë process FSHSHC ka ngritur Forume të OJF-ve në disa rrethe të largëta të vendit si Peshkopi, Burrel dhe Permet.

Nisur nga nevoja e zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë civile në përgjithësi dhe fuqizimit të rolit të OJF-ve lokale në komunitet FSHSHC zbatoi projektin e mësipërm mbështetur nga Abasada Norvegjeze.



Për një periudhë gjashtë mujore FSHSHC financoi 42 mini-projekte te OJF-ve locale në zonat Burrel, Bulqizë, Peshkopi dhe Përmet dhe dy projekte në rrethin e Krujës

Grupet e fokusimit për këto mini-projekte ishin: gratë, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara.

Nga monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të projektit FSHSHC ka vërejtur se:

- o Aktivitetet e organizuara nga OJF-të në zona të ndryshme janë kryesisht të karakterit ndërgjigjësues. Ato konsistojnë në shpërndarje fletëpalosjesh, organizim anketimesh, apo seminare të cilat janë mjete mjaft efektive. Megjithatë duke u përdorur shumë shpesh rrezikojnë të bëhen monotone dhe për pasojë nuk shoqërohen me ndikim të mjaftueshëm. Prandaj OJF-të duhet të jenë më krijuese përsa i përket shumëllojshmërisë së aktiviteteve në mënyrë që të arrijnë të organizojnë aktivitete gjithnjë e më efektive.



- Eshtë bërë kujdes që grupet e fokusimit të jenë kryesisht grupet e marginalizuara, gjë që ka kontribuar në integrimin e kësaj kategorie në shoqëri.
- Megjithëse FSHSHC ka organizuar trainime të OJF-ve në zonat ku u zbatua projekti, ato ende kanë mangësi në analizën e nevojave të komunitetit në mënyrë që të trajtojnë problemet më thelbësore, në hartim projektesh dhe në vlerësimin e rezultateve të projekteve.
- Me krijimin e Forumeve të OJF-ve, FSHSHC ka institucionalizuar bashkëpunimin mes OJF-ve, duke iu siguruar atyre pajisjet e nevojshme dhe duke nxitur projekte të përbashkëta të OJFve. Megjithatë vetëm disa prej tyre kanë paraqitur projekte të përbashkëta të cilat në raportet me projektet e
- Qeveritë lokale gjithnjë e më shumë treguan interes për projektin duke marrë pjesë në tryezat e rrumbullakta të organizuara mbi pjesmarrjen publike në vendim marrje. Megjithatë praktikisht ata ende nuk krijojnë mundësi për publikun që të shprehen për zgjidhjen e problemeve të komunitetit. Nga ana tjetër Ende mbizotëron në një shkallë të konsiderueshme koncepti që komuniteti ia ka deleguar përfaqësuesve të zgjedhur të drejtën për të vendosur për problemet duke përjashtuar veten nga procedurat.

Disa nga rezultatet e projektit:

- Përmes zbatimit të projektit FSHSHC kontribuoi në zhvillimin e modeleve të reja të vetë-qeverisjes me krijimin e bordeve lokale të OJFve për shpërndarjen e fondeve për projektet e OJF-ve. Bordet tashmë kanë përfutur përvojë në



tjera ishin të hartuara më mirë dhe më efektive.



vërehet hezitim dhe indiferencë nga vetë publiku për të marrë pjesë në vendim marrje.



- vlërësimin e projekteve edhe pse ato ishin të vogla.
- Tryzat e rumbullakta dhe diskutimet e hapura u provuan si mjete të frytshme për nxitjen e dialogut dhe debatit konstruktiv ndërmjet komunitetit dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal si premisë për decentralizimin e qeverisjes lokale.